



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.13, datë 28/03/2023

PËR

**KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR. 8, DATË 26.07.2018
PËR MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR”, PËR PRODHIM HIDROENERGJIE, PËR HEC “SHUTRI 1
DHE SHUTRI 2”, DUKE SHFRYTËZUAR UJIN E RRJEDHËS SË
PËRROIT TË SHUTRISË DHE UJIN E BURIMIT TË
SHUTRISË, BASENI UJOR MAT ME VENDNDODHJE, NË
NJËSINË ADMINISTRATIVE RUKAJ TË BASHKISË
MAT, OARKU DIBËR, SUBJEKTIT “ATEANI ENERGY” SH.P.K”**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe referuar nenit 112, të Kodit të Procedurave Administrative “**Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ**” 1. Organi publik, në cdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korigjohet, si dhe të cdo kopje të njëhsuar të tij. Në këto kushte: Me kërkesë të subjektit dhe me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore pasi u konstatua se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Ujqor Mat,

V E N D O S I:

1. Korrigojmë gabimet material në “leje për përdorim burimi ujor për prodhim hidroenergje, subjekti “ATEANI ENERGY”SH.P.K Në periudhën e vlefshmërisë: Nga 26/07/2018 - 25/07/2023 në “Sipas afatit të koncensionit”.
2. Asnjë trgues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material (Nga 26/07/2018 - 25/07/2023 në “Sipas afatit të koncensionit”.)
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBUMAT

GJERGJ PRENDI

